

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarës F.G.nga fshati D. Komuna e P., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komonale në Prishtinë-tani Prokuroria Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.2078/03 të datës 16.02.2003, pas përfundimit të shqyrtimeve gjyqësore publike në praninë e Prokurorit të Shtetit-Atdhe Dema, të dëmtuarve, të akuzuarës dhe mbrojtësit të saj sipas autorizimit av. H. G., me datë 11.12.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara F. G., e bija e Sh. dhe nënës E. e vajzërisë R., e lindur më *data e lindjes...*, në fshatin K., Komuna e P., tani me vendbanim në fshatin D., KK.P., me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën fillore, me profesion shitëse, e martuar, nënë e tre (3) fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, më parë e pa gjykuar, kundër saj nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptare-Shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse:

Me datë 09.08.2003, rreth orës 12:20, në rrugën lokale Podujevë-Kërpimëh, në fshatin Peran, përballë dyqanit të autolarjes me firmën “G.”, duke e drejtuar veturën e markës “Mercedes-201”, me tabela të regjistrimit *numër i targave...*, nga pakujdesia ka rrezikuar komunikacionin dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos iu përmbajtur rregullave të komunikacionit e cila ka ra në kundërshtim me nenin 42.2 të LPSKRR, dhe atë për shkak të mos verifikimit të gjendjes së pjesëmarrësve të komunikacionit në rrugë, në mënyrë që të tjerët të mos i pengoj, e njëjta pasi me veturë niset nga dyqani i autolarjes me emrin “G.”, pa u bindur mirë për kuçje të sigurt në rrugë kryesore për një çast me veturën e saj është kyçur në rrugë kryesore në drejtimin për në fshatin Kërpimëh, ku në ato çaste derisa ka qenë duke qarkulluar vetura “Opel Corsa” me tabela të regjistrimit *numër i targave...*, të cilën e ka drejtuar tani i ndjeri Sh. G., në drejtim për në fshatin Kërpimëh, ashtu që i njëjti me qëllim që t’i shmangët ndeshjes me veturën e të pandehurës, për një çast ka frenuar dhe krejtësisht ka kaluar me veturë në anën e djathtë të trotuarit të rrugës ku nga shkak i frenimit vetura e tij ka filluar që të sillet, me ç’rast e njëjta ka kaluar në anën e majtë të kundërt të shiritit të rrugës, ku në ato qaste nga drejtimi i kundërt prej fshatit Kërpimëh për në Podujevë ka qenë duke qarkulluar vetura e markës “Opel Askona”, me tabela të regjistrimit *numër i targave...*, të cilën e drejtonte Y. H., ashtu që për një çast vetura “Opel Aksona” me pjesën e përparme e godet veturën “Opel Corsa”, në pjesën e anësore të majtë të dera e shoferit, ku nga shkak i

kësaj goditjeje shoferi i veturës “Opel Corsa” tani i ndjerë Sh. G. dhe bashkudhëtari i tij tani i ndjerë A. Z. pësojnë lëndime të rënda vdekjeprurëse në pjesë të ndryshme të trupit, shkak i të cilave po të njëjtën ditë vdesin në QKUK të Prishtinës, kurse bashkudhëtarët tjerë të këtyre dy veturave T. B., Y. H., A. H. dhe Xh. S. kanë pësuar lëndime të lehta trupore.

-Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4,7,17,23,41,42,49,50,51,52,74,76 dhe nenit 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPPRK-së., si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarën F. (Sh.) G., me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afat prej 3 (tri) viteve nuk kryen vepër të re penale.

II. Detyrohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate dhe në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumën prej **200€ (dyqind euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Të dëmtuarit: F. G., E. Z., A. H., T. B. dhe Xh. S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

PPK-tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.nr.2078-2/2003 të datës 16.02.2003, kundër të akuzuarës F.G., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata mbajti shqyrtimet gjyqësore me datë 27.06.2014, 01.07.2014, 20.10.2014, 04.11.2014, 25.11.2014, 10.12.2014, 11.12.2014, në praninë e prokurorit të Shtetit, të dëmtuarve, të akuzuarës dhe mbrojtësit të saj.

Në shqyrtimin fillestar Prokurori i shtetit fillimisht e ka plotësuar dispozitivin e aktakuzës në reshtin e 5 me dispozitën e nenit 42.2 të LPSKRR, dhe ka bërë rikualifikimin e veprës penale me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, si ligj më i favorshëm në kuptim të nenit 3 par. 2 të këtij kodi për veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit e akuzuara në shqyrtimin fillestar dhe deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u deklarua e pafajshme për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Mbetem në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarës F.G., për shkak të kryerjes së veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, ngase aktakuza është e bazuar në ligj dhe e përpiluar në përputhje me ligjin dhe se e njëjta është e bazuar në provat e pranueshme të cilat

prova janë siguruar në harmoni të plotë në dispozitat ligjore. Po ashtu ka theksuar se nga provat e nxjerra në shqyrtim gjyqësor jam i bindur që në tërësi u vërtetua se e akuzuara ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar, i propozoi gjykatës që të akuzuarën ta shpall fajtores dhe ta ndëshkoj sipas ligjit dhe gjatë shqiptimit të dënimit të merr parasysh si rrethanë rënduese mos pranimit e kryerjes së veprës penale, mos pendimin e saj si dhe vendosmërinë e lartë për kryerjen e veprës penale.

Të dëmtuarit në fjalën përfundimtare, F. G., E. Z., A. H., T. B. parashtruan kërkesë pasurore-juridike, i dëmtuari Y. H. deklaroi se nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike pasi që është kompensuar nga Kompania e Sigurimit, ndërsa i dëmtuari Xh. S. i cili nuk ka prezantuar në shqyrtimin gjyqësor për shkak se gjendet në botën e jashtme, udhëzohet për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil.

Mbrojtësi i të akuzuarës në fjalën përfundimtare deklaroi: Se me bindjen time rreth kësaj çështje nuk mendoj se me prova të argumentuara është provuar kryerja e veprës penale nga ana e të mbrojturës sime në kohë, dhe vend siç është theksuar në aktakuzë. Asnjë provë materiale në procedurën hetimore nuk ka mundur të theksoj se e pandehura F.G. ditën kritike ka dalë me veturën e saj prej autolarjes, u kyç në rrugë dhe si pasojë e kësaj është shkaktuar aksidenti. Asnjë prej dëshmitarëve prezent dhe prej atyre që kanë dhënë deklaratë nuk kanë thënë dhe nuk ia kanë zgjatur gishtin se e mbrojtura ime është ajo e cila ditën kritike ka qenë në fshatin Peran. Për këtë arsye i propozoj gjykatës që të mbrojturën time në kuptim të Kodit të Procedurës Penale, ta liroj nga dënimi dhe përgjegjësia penale. Në variantin më të pafavorshëm nëse gjykata gjen se në veprimet e të mbrojturës sime ekzistojnë sa do pak elemente të figurës së veprës penale, i propozoj gjykatës që duke marrë parasysh rrethanat se e mbrojtura ime asnjëherë nuk ka ra në kundërshtim me ligjin, është e martuar dhe nënë e tre fëmijëve, rrjedh nga një familje jashtëzakonisht e mirë dhe se në asnjë variant pasojën e veprës penale nuk e ka dashur, kohën e kryerjes së veprës penale që tani është mbi 11 vite, rrethanë tjetër që ajo ka një gjendje jashtëzakonisht të varfër, jeton nga një shitore së bashku me bashkëshortin dhe fëmijët e saj, kërkoj nga gjykata që me aplikimin e dispozitave mbi zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të njëjtës t'i shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë e mundësisht të kushtëzuar.

E akuzuara në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, veç tjerash, deklaroi se ditën kritike kam qenë në lokalin tim me burrin tim dhe shtoi se posedon patentë shoferin qe 16 vite, e pranon se ka në pronësi një "Mercedes"190 me ngjyrë hiri, e i cili është i regjistruar në emër të bashkëshortit dhe shtoi se më shpesh e vozit bashkëshorti, po ashtu theksoi se pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj dhe kërkoj nga gjykata që ta liroj nga dënimi nga se e ndjen veten të pafajshme për shkak se nuk ka qenë në këtë rast.

Gjykata gjatë procedurës se provave ka dëgjuar të dëmtuarit-dëshmitarët: Y. H., T.B., M. O., A. H., si dhe është dëgjuar eksperti F. B. dhe janë lexuar: Dokumentacioni i QKUK-së i datës 09.08.2003, ekspertizat mjeko-ligjore për katër (4) të lënduarit të datës 03.03.2004, skica dhe fotografitë e vendit të ngjarjes, dhe është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarës, të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konfom nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërjegjeje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi gjatë administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata nga deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit Y. H. ka vërtetuar gjendjen faktike, i cili veç tjerash deklaroi: Rreth orës 12:00, Gusht 2003 kam qenë duke e drejtuar automjetin e tipit “Opel Ascona” në anën e djathtë në drejtim të Podujevës, dhe kam vërejtur një “Mercedes” me ngjyrë hiri të cilin e drejtonte një femër që tani është e akuzuar, ka dal nga autolarja dhe është drejtuar në drejtim të fshatit Kërpimeh, në atë moment automjeti me ngjyrë të zezë “Opel Corsa” i cili vinte nga Podujeva ka filluar të bënë disa lëvizje dhe jam përplasur me të në anën e djathtë të rrugës.

Gjykata nga deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit T.B. ka vërtetuar gjendjen faktike, i cili veç tjerash deklaroi: Ditën kritike kemi qenë duke shkuar nga Podujeva për në fshatin Kërpimeh, kur kemi shkuar te autolarja ka dal një “Mercedes” me ngjyrë hiri të cilin e voziste tani e akuzuara, i kemi ikur dhe jemi përleshur me veturën e Y. H., të akuzuarën kam arritur që ta shoh në krahun e majtë dhe fytyrën kur e kemi bërë tejkalimin.

Gjykata nga deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit A. H. ka vërtetuar gjendjen faktike, i cili veç tjerash deklaroi: Se data nuk më kujtohet por aksidenti më kujtohet shumë pastër nga fillimi deri në fund, se ne kemi qenë duke ardhur nga fshati Dobratin për në Podujevë, kur kemi ardhur tek vendi i ngjarjes në fshatin Peran te sharra, një “Mercedes” ka dalë nga autolarja, e ka prerë rrugën, ka ardhur automjeti “Opell Corsa” nga Podujeva, për mos me e rrokë “Mercedesin” ka hyrë në trotuar në anën e djathtë, ka tentuar me hy në shiritin e vet, nuk ka mundur dhe ka dalë në shiritin në drejtim tonin, shoferi jonë ka frenua, ai është munduar të dal prapë në shiritin e vet, është bajtë dhe e di që është goditur me neve, dhe ka shtuar jam shumë i sigurt që është dalë dhe na ka prerë rrugën vetura “Mercedes”, ngjyrë hiri, se po të mos kishte dalë nuk do të kishte ndodhur aksidenti.

Nga deklaratat e të dëmtuarit-dëshmitarit Xh. S. e dhënë para ish gjyqtarit hetues të Gjykatës Komonale në Podujevë, në procesverbalin e datës 05.12.2003, (deklaratë kjo e administruar në shqyrtimin gjyqësor me propozim të mbrojtjes) vërtetohet gjendja faktike, i cili veç tjerash ka deklaruar, se me datë 09.08.2003 diku rreth orës 12:00 prej fshatit Dobratin kam hipur në veturën “Opel Ascona”, me targa *numër i targave...* automjet taksi të cilën e drejtonte Y.H. jemi nisur dhe me të arritur afër autolarjes “G.” një “Mercedes” i ngjyrës së bardhë i cili ishte në anën e djathtë ka dal prej servisit autolarje në drejtim të fshatit Kërpimeh, kurse automjeti i cili vinte në drejtim Podujevë-Kërpimeh, ka bërë tejkalimin në mënyrë jo të rregullt të “Mercedesit” i cili është dal nga servisi i autolarjes, e humb drejtimin e lëvizjes në automjet dhe është ndesh me automjetin tonë “Opel Ascona” i cili qarkullonte në drejtim Kërpimeh-Podujevë.

Dëshmitari M. O. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash deklaroi, se pranoj që ka dhënë deklaratë dhe e ka nënshkruar para gjyqtarit hetues mirëpo nuk i kujtohet se çka ka thënë dhe si ka ndodhur aksidenti me arsyetimin se ka qenë shumë i ri, ndërsa në deklaratën e dhënë para ish gjyqtarit hetues të Gjykatës Komonale në Podujevë, me datë 04.05 2004 për veç tjerash ka deklaruar: me datë 09.08.2003, rreth orës 12:20 në rrugën lokale Podujevë-Kërpimeh në fshatin Peran në autolarjen “G.” e përmendura të cilës emrin nuk ja kam ditur as që e njoh edhe sot, e ka larë një “Mercedes” të bardhë, dhe pas larjes në dyqanin tim është kyç në rrugën për në fshatin Kërpimeh.

Gjykata nga mendimi dhe konstatimi i Ekspertit të komunikacionit F. B. i dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.10.12.2014 ka vërtetuar gjendjen faktike, i cili veç të tjerash deklaroi: Shkaktar primar në këtë aksident është automjeti “Mercedes” i cili ishte kyçur në rrugën me përparësi kalimi në mënyrë të befasishme me ç`rast ngasësi i automjetit “Opel Corsa” kishte marrë veprimin e ikjes nga goditja me automjetin “Mercedes” dhe si rezultat

kishte humbur kontrollin mbi automjetin e tij duke dalë në skajin e djathtë të rrugës, jashtë rrugës, dhe duke u mundur që ta vënë nën kontroll automjetin e tij kishte kaluar në anën e majtë të rrugës duke u bartur me ç'rast ishte goditur nga automjeti "Askona". Kurse lëshimet sekondare ishin të ngasësit të automjetit "Askona" i cili nuk e kishte respektuar kufizimin e shpejtësisë.

Nga ekspertizat mjeko-ligjore të dt.03.03.2004 nga eksperti specialist Dr. B. Th., gjykata ka vërtetuar se si pasojë e aksidentit të komunikacionit të dëmtuarit T. B., Y. H., A. H. dhe Xh. S. kanë pësuar lëndime të lehta trupore.

Nga dokumentacionet mjekësore të QKUK-së, të dt.09.08.2003 për të ndjerët Sh. G. dhe A. Z. i gjykata ka vërtetuar se si shkak i vdekjes së të ndjerëve ka ardhur si pasojë e lëndimeve të rënda të organeve vitale të pësuar nga ky aksident komunikacioni.

Nga ekspertiza e dt.07-08.10.2003 të ekspertit të ndjerë ing. M. K., gjykata ka vërtetuar se aksidenti ka ndodhur nga lëshimet primare të akuzuarës F.G.e cila e ka drejtuar veturën B-2 të markës "Mercedes" me targa të regjistrimit *numër i targave...*, ka lëviz-respektivisht ka dal nga autolarja "G." dhe është kyçur në rrugë kryesore Podujevë –Kërpimeh, pa i verifikuar paraprakisht se a i pengon-rrezikon pjesëmarrësit e tjerë të cilët lëvizin nga drejtimi Podujevë –Kërpimeh apo në drejtim të kundërt, me ç'rast nga drejtimi Kërpimeh-Podujevë ka qenë duke lëvizur i ndjeri Sh. G. me veturën A-1 "Opel Corsa", me targë të regjistrimit *numër i targave...*, të cilit ja ka prerë rrugën në befasi dhe nga ky shkak Sh. G. ka qenë i detyruar ta bëjë me dhune tejkalimin ndaj veturës së F.G.t nga krahu i anesës së djathtë duke dal me veturë në bankinën e krahut të djathtë, ku pastaj Sh. e hup kontrollin ndaj timonit dhe me ç'rast del me veturën e tij në shiritin e krahut të majtë në drejtim të lëvizjes Podujevë – Kërpimeh e që në atë moment nga drejtimi i kundërt Kërpimeh-Podujevë ka qenë duke lëvizur Y. H. me veturën C-3 të markës "Opel Ascona" me targa të regjistrimit *numër i targave...* të cilin e ka goditur në pjesën e përparme të krahut të majtë, në anën –krahun e derës së përparme të majtë. Ndërsa e akuzuara depërton-kalon pa arritur deri te kontakti me veturën A-1 "Opel Corsa" dhe C-3 "Opel Ascona" dhe largohet nga vendi i aksidentit dhe pse ishte shkaktare kryesore e aksidentit. Ndërsa lëshime sekondare kishte i ndjeri Sh. G. i cili kishte dalë në shiritin e kundërt dhe kishte lëvizur me shpejtësi prej 90 km/h, e ku ishte e kufizuar me 40km/h.

Nga skica e vendit të ngjarjes të dt.19.09.2013 shihen pozitat përfundimtare të automjetit "Opel Corsa" me targa *numër i targave...* dhe "Opel Ascona" me targa *numër i targave...*, gjurmët e frenimit dhe pika e kontaktit të këtyre automjeteve.

Nga fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës shihen të nderit Sh. G. dhe A.Z., pozitat përfundimtare të automjetit "Opel Corsa" me targa *numër i targave...* dhe "Opel Ascona" me targa *numër i targave...*, dhe gjurmët e frenimit.

Nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ing. i dipl. F. B. e datës 10.12.2014, gjykata ka vërtetuar se aksidenti ka ndodhur nga lëshimet primare të ngasëses të automjetit "Mercedes" e cila kishte bërë kyçje të rrezikshme në rrugë me përparësi kalimi duke mos i dhënë përparësi kalimi automjetit "Corsa" me ç'rast automjeti "Corsa" e kishte humbur kontrollin gjatë lëvizjes dhe kishte përfunduar në shiritin e drejtimit të kundërt, ndërsa aksidenti ishte shkaktuar edhe nga lëshimet sekondare të ngasësit të automjetit "Askona" i cili nuk e kishte respektuar kufizimin e shpejtësisë për atë pjesë së rrugës që ishte 40[km/h] me ç'rast nuk kishte arritur që ta ndal automjetin e tij pa e goditur automjetin "Corsa".

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, gjykata sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plotë deklaratave të dëmtuarve - dëshmitarëve, Y. H., T. B., A. H., Xh. S., dëshmitarit M. O. e të cilat deklarata kanë lidhshmëri njëra me tjetrën, nga të cilat u vërtetua

se e akuzuara ditën kritike për shkak të mos verifikimit të gjendjes së pjesëmarrësve të komunikacionit në rrugë, në mënyrë që të tjerët të mos i pengoj, e njëjta pasi me veturë niset nga autolarja me emrin “G.”, pa u bindur mirë për kyçje të sigurt në rrugë kryesore për një çast me veturën e saj është kyçur në rrugë kryesore në drejtimin për në fshatin Kërpimeh, ku në ato çaste derisa ka qenë duke qarkulluar vetura “Opel Corsa” me tabela të regjistrimit *numër i targave...*, të cilën e ka drejtuar tani i ndjeri Sh. G., në drejtim për në fshatin Kërpimeh, ashtu që i njëjti me qëllim që t’i shmanget ndeshjes me veturën e të akuzuarës, për një çast ka frenuar dhe krejtësisht ka kaluar me veturë në anën e djathtë të trotuarit të rrugës ku nga shkaku i frenimit vetura e tij ka filluar që të sillet, me ç’rast e njëjta ka kaluar në anën e majtë të kundërt të shiritit të rrugës, ku në ato çaste nga drejtimi i kundërt prej fshatit Kërpimeh për në Podujevë ka qenë duke qarkulluar vetura e markës “Opel Askona”, me tabela të regjistrimit *numër i targave...*, të cilën e drejtonte Y. H., ashtu që për një çast vetura “Opel Aksona” me pjesën e përparme e godet veturën “Opel Corsa”, në pjesën e anësore të majtë te dera e shoferit, ku nga shkaku i kësaj goditjeje aksidenti i komunikacionit ka rezultuar me dy persona të vdekur dhe katër të lënduar.

Po ashtu gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u vërtetua nga konstatimi dhe mendimi i ekspertëve të cilët me metoda shkencore duke u bazuar në skicën dhe fotografitë e vendit të ngjarjes të cilët kanë theksuar se deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve primare të akuzuarës e cila kishte bërë kyçje të rrezikshme në rrugë me përparësi kalimi duke mos i dhënë përparësi kalimi automjetit “Corsa”, me ç’rast automjeti “Corsa” e kishte humbur kontrollin gjatë lëvizjes dhe kishte përfunduar në shiritin e drejtimit së kundërt, ndërsa aksidenti ishte shkaktuar edhe nga lëshimet sekondare të ngasësit të automjetit “Askona” i cili nuk e kishte respektuar kufizimin e shpejtësisë për atë pjesë së rrugës që ishte 40[km/h] me ç’rast nuk kishte arritur që ta ndal automjetin e tij pa e goditur automjetin “Corsa”.

Kjo gjykatë nga deklarata tani e të akuzuarës vërtetohet se kanë në pronësi një “Mercedes” 190 me ngjyrë hiri dhe që e njëjta edhe drejton këtë veturë.

Kjo gjykatë nga deklarata e të akuzuarës vërtetoi se e akuzuara posedon veturën “Mercedes” 190 me ngjyrë hiri e cila është e regjistruar në emër të bashkëshortit të saj e të cilën edhe e vozit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarës, e cila ka bërë kyçje të rrezikshme duke i penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion me çka ka shkel nenin 42.2 të LPSKRR, me shkeljen e nenit të lartcekur përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se e akuzuara e ka kryer veprën nga pakujdesia, duke mos i kushtuar vëmendje të mjaftueshme pa i verifikuar paraprakisht se a i pengon-rrezikon pjesëmarrësit e tjerë për çka edhe është shkaktuar aksidenti dhe ka rezultuar me dy të vdekur.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarës, kështu që gjykata gjeti se e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarës duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit në mënyrë të hollësishme analizoi mbrojtjen e të akuzuarit të ushtruar nga mbrojtësi i saj av.H. G..

Mbrojtësi i të akuzuarës i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka propozuar që në cilësi të dëshmitarëve të ftohen Xh. dhe R. G., daljen në vendin e ngjarjes, gjykata këto propozime i ka refuzuar si të pa bazuara në shqyrtimin gjyqësor, dëshmitarët e lartcekur si familjarë të akuzuarës të cilët kanë qenë në shtëpi ditën kritike, gjykata konsideron se janë të pa nevojshëm dhe jo relevante për çështjen konkrete, e po ashtu që të dilet në vendin e ngjarjes, gjykata e ka refuzuar nga se në vendin e ngjarjes kanë dalë hetuesit policor, gjyqtari hetues, dhe ekspertët e komunikacionit, dhe e kanë kryer punën e tyre profesionale, e po ashtu është refuzuar edhe propozimi i mbrojtjes për kryerjen e një super-ekspertize, nga se për këtë çështje penale juridike janë kryer dy ekspertiza dhe po ashtu eksperti F.B. është dëgjuar në shqyrtim gjyqësor e që mbrojtja e ka shfrytëzuar të drejtën e parashtrimit të pyetjeve, ashtu që kjo gjykatë konsideroi se është e panevojshme dhe e tepërt të kryhet super-ekspertizë, nga se të dy ekspertët kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre të njëjtë lidhur me lëshimit apo shkaktarin kryesor të aksidentit të komunikacionit, dhe këto propozime gjykata i konsideroi se janë bërë me qëllim të vetëm të zvarritjes së procedurës penale.

Gjykata nuk e akceptoi kërkesën e mbrojtjes për lirimin e të akuzuarës nga dënimi dhe përgjegjësia penale, sepse është vërtetuar përtej çdo dyshimi gjendja faktike nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar se nga kryerja e veprës penale kanë kaluar mbi 11 vite, e akuzuara ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj saj. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarës, rrethanë tjetër është edhe fakti se aksidentit i ka kontribuar edhe drejtuesi i automjetit “Askona” i cili nuk e ka respektuar kufizimin e shpejtësisë. Rrethanë rënduese gjykata gjeti peshën e rëndë të veprës penale të shkaktuar nga veprimet e të akuzuarës, dhe duke mos u ndal fare në vendin e ngjarjes. Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata duke zbatuar dispozitat për zbutje të dënimit në bazë nenit 52 par 2 dhe nenit 76 par.1 pika 1.5 të KPPRK-së, të akuzuarën e shpalli fajtores dhe e gjykoj me dënim me kusht konform nenit 52 par. 2 të KPPRK-së, në lartësinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i kushtëzuar i shqiptuar të akuzuarës është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, të parandalojë kryerësen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëj rehabilitimin e saj, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme që të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, e që janë të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marrë në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.161/2004, dt. 11.12.2014**

**Sekretarja Juridike
Mihrie Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.